



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 678 Prot.

Tiranë, më datë 27.04.2023

VENDIM
Nr. 256, datë 27.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 27.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Restaurimi dhe rijetëzimi i banesës me Kod Arkivi M-060, sot në pronësi të Gledis Sazan Guri, në lagjen Mangalem, Berat”, Monument Kulture i Kategorisë së II-të, Brenda Kufirit Qendër Historike Berat, me aplikues Fatjon Saliu dhe zhvillues **Sazan Guri** dhe plotësimin e aplikimit me pikat e mëposhtme:
 - Të plotësohet projekti me foto të gjendjes ekzistuese;
 - Të plotësohet projekti me një analizë të saktë të degradimit të objektit;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

